

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 16, 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve (Tekst i pastër) ark.nr.01-4898/1 datë 22.11.2024 pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për marrjen e masave (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4193/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4942/1 datë 27.11.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-5193/6 datë 26.12.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024, miratoi sa vijon:

Aktvendim për ndërmarrjen e masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, për shkeljen e kryer të nenit 50 paragrafi (3) të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (LSHMAAV) dhe nenet 16, 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtje e të miturve (RRMPM), të mënyrës që në shërbimin programor televiziv të radiodifuzerit, transmetuar më 4 nëntor 2024:

- rishfaqje nga filmi artistik "The Boondock Saints (Shenjtorët e rrethinave)" është shënuar si program i kategorisë së katër (16+), është transmetuar në kohë të papërshtatshme të ditë-natës dhe
- para transmetimit të disa programeve të kategorisë së parë, të dytë dhe të katërt, është përdorur sinjalistikë e pasakta paralajmëruese për mbrojtjen e të miturve, që nuk parashihet në RRMPM.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4942/1 datë 27.11.2024, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimin të këtij aktvendimi ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM.

3. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesit) ndërmerr masë - vërejtje publike në rastet kur ka cënim ose shkelje të dispozitave të LSHMAAV dhe aktet nënligjore miratuar në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 50 paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit nuk mund të transmetojnë ose bartin programe që mund të dëmtojnë seriozisht zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, veçanërisht programe që përmbajnë pornografi ose dhunë të tepruar. Ofruesit e shërbimeve, sipas kërkesës, duhet të marrin masat teknike të rrepta për të siguruar që të miturit të mbrohen nga përmbajtje të dëmshme si dhuna e tepruar dhe pornografia. Përveç programeve nga paragrafi (1) i këtij neni, programe të tjera që mund të dëmtojnë zhvillimin fizik, mendor dhe moral të të miturve, ofrohen nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale në mënyrë që të miturit të mos munden në mënyrë të zakonshme t'i shohin ose dëgjojnë programet. Kur programet transmetohen ose rishikohen në formë të pa koduar, ofruesi i shërbimeve mediatike audiovizive është i detyruar që para transmetimit të tyre të siguron paralajmërim paraprak akustik dhe

mundësinë që të njihet me ndihmën e shenjave vizuale gjatë gjithë transmetimit të programeve (neni 50 paragrafi 3 i LSHMAAV).

Neni 16 i RRMPM (periudha kohore për kategoritë e programeve) është përcaktuar se në varësi të përbërjes së pritshme të publikut, kategoritë e programit mund të transmetohen në periudhat e mëposhtme kohore: programet e kategorisë së parë dhe të dytë transmetohen gjatë gjithë ditë-natës; kategoria e tretë transmetohet në periudhën prej orës 20:00 deri në ora 05:00; kategoria e katërt transmetohet në periudhën prej orës 22:00 deri në ora 05:00; kategoria e pestë transmetohet në periudhën prej orës 00:00 deri në ora 05:00.

Neni 20 i RRMPM parasheh mënyrën e aplikimit të sinjalistikës paralajmëruese. Në përputhje me paragrafit (1) të Ligjit të njëjtë para fillimit të programeve televizive përfshirë në nenin 19 të Rregullores (Përmbajtja në të cilën aplikohen sinjalistika paralajmëruese), detyrimisht transmetohet sinjali paralajmërues që korrespondon me kategorinë e programit që është kombinim i shenjës vizuale, tekstit, paralajmërimit verbal dhe akustik, që vazhdon së paku 10 sekonda dhe përfshin së paku 1/4 e pjesës së dukshme të ekranit.

Në nenin 21 të RRMPM (Pamja dhe përmbajtja e sinjalistikës paralajmëruese), ndër të tjera, parashikohet që sinjalistika paralajmëruese që aplikohen para, deri ose gjatë programeve nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuale: për programet e klasifikuara në kategoria e parë, duhet të qëndrojnë shenja "për gjithë publikun" dhe të shkruhet teksti i paralajmërimit: "Programe të kategorisë së parë destinuar për të gjithë publikun"; për programet e klasifikuara në kategorinë e dytë duhet të qëndrojnë numri "8" dhe shenja "+", si dhe teksti i paralajmërimit: "Programet e kategorisë së dytë nuk rekomandohen për fëmijët nën 8 vjeç". Mbikëqyrja nga prindi ose kujdestari është i domosdoshëm.", dhe për programet e klasifikuara në kategorinë e katërt duhet të qëndrojnë numri "16" dhe shenja "+", si dhe teksti i paralajmërimit: "Programet e kategorisë së katërt që nuk rekomandohen për fëmijët nën 16 vjeç. Mbikëqyrja nga prindi ose kujdestar është i domosdoshëm."

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për Çështje Programore, më 27 nëntor 2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, transmetuar më 4 nëntor 2024, në nivel lokal, në të cilin është konstatuar shkelje të nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 16, 20 dhe 21 të RRMPM.

Përkatësisht, me mbikëqyrjen e rregullt programore të shërbimit programor televiziv të SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, transmetuar më 4 nëntor 2024, në nivel lokal, është konstatuar shkelje e nenit 50 paragrafi (3) të LSHMAAV dhe nenet 16, 20 dhe 21 të RRMPM. Në kundërshtim me nenin 16 (periudhat kohore për kategoritë e programit) të RRMPM, rishfaqje e filmit artistik "The Boondock Saints" (Shënjtoret e rrethinave) është shënuar saktë si program i Kategorisë së katërt (16+), por u transmetua në periudhë kohore të papërshtatshme të ditë-natës. Sipas udhëzimeve të RRMPM, programet skenari i të cilave përfshin përshkrime sistematike dhe të shpeshta, skena dhe/ose pamje të dhunës psiko-fizike, që mund të shqetësojnë të miturit dhe klasifikohen si - program i kategorisë së katërt (16+), që nuk rekomandohen për fëmijët nën 16 vjeç, për të cilët është i domosdoshëm mbikëqyrja nga prindi/kujdestari, mund të transmetohet vetëm në periudhën prej orës 22:00 deri në orën 05:00.

Në kundërshtim me nenet 20 dhe 21 të RRMPM (*mënyra e aplikimit, pamja dhe përmbajtja e sinjalit paralajmërues*), para transmetimit të disa programeve të kategorisë së parë, dytë dhe të katërt, është përdorur sinjalistikë e pasaktë paralajmëruese që nuk është e përshkruara në RRMPM. Bëhet fjalë për premiera dhe edicione të përsëritura të programeve me funksione të ndryshme mediatike.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim mbi mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4942/1 datë 27.11.2024, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, më 29.11.2024 dërgoi Shkresë nr.y në ark.10-4942/2 datë 29.11.2024, ku i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.10-4942/1 datë 27.11.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzohet deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi, më 03.12.2024 nga ku në afatin e parashikuar SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar nuk ka dorëzuar deklaratë me shkrim për shkeljen e bërë të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM. Këshilli i Agjencisë, në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024, shqyrtoi raportin me shkrim dhe konstatoi që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 50 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë dhe nenet 16, 20 dhe 21 të RRMPM, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për marrjen e masave (Teksti i pastruar), Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4942/1 datë 27.11.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-5193/6 datë 26.12.2024, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV dhe RRMPM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 46-të mbajtur më 25.12.2024, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizohet punën e tij me dispozitat e LSHMAAV dhe RRMPM. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit. Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-4942/1 datë 27.11.2024

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.